



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 979/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Ardian Latifi, Erestina Isufi, Gentiana Bajrami, Vlora Kastrati, Rexhep Sejdiu, Hana Saqipi, Endrit Shabani, Sali Sadiku, Hevzi Xhelili, Ardian Hajrullahu, Visar Ismajli dhe Flamur Ramadani të gjithë kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.979/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Ardian Latifi, Erestina Isufi, Gentiana Bajrami, Vlora Kastrati, Rexhep Sejdiu, Hana Saqipi, Endrit Shabani, Sali Sadiku, Hevzi Xhelili, Ardian Hajrullahu, Visar Ismajli dhe Flamur Ramadani të gjithë kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga 12 kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjilan, me të cilën pretendojnë se në bazë të provave të cilat i posedojnë secili nga ata, konsiderojnë se gjatë numërimit të votave nga ana e komisionerëve në shumicën e qendrave të votimit, janë bërë gabime të qëllimshme ose jo, duke manipuluar votat në atë mënyrë që gjatë numërimit të tyre, pretendojnë se ekziston mundësia e numërimit të votave në emër të ndonjë kandidati tjetër ose shpallja e votave si të pavlefshme.

Andaj e njëjtë kërkojnë që të rinumërohen vendvotimet si ne vijim: në fshatrat Livoq i Ulët, Livoq i Epërm, Malishevë, Dobërçan, Bresalc, Përlepnice, Velekincë, Zhegër, Čerñicë, Lladovë, Kmetoc si dhe në të gjitha vendvotimet e Gjilanit.

Parashtruesit e apelit nuk kanë bashkangjitur asnjë provë si dëshmi.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesit e apelit në mbështetje të pretendimeve të tyre, nuk kanë ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për bartje të votave tek ndonjë kandidat tjetër apo edhe shpallja e votave si të pavlefshme, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave apo manipulime të votave të parashtruesve të apelit gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tyre nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesve për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultate përfundimtare, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i 12 kandidatëve për Kuvend të Komunës së Gjilanit, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat, andaj kërkesa e apellesve për të rinumëruar të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për kuvend komunal në Gjilan, vlerësohet si i pa bazuar. Shkaqet për rinumërimin e plotë të gjitha fletëvotimeve në një Komunë të tërë, sipas vlerësimit të panelit do duhej të jenë shumë serioze dhe bindëse, si dhe të rezultojnë nga provat e mjaftueshme, bindëse dhe të pa kontestueshme, te cilat në rastin konkret mungojnë.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nga kandidatët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjilan nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.979/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.